



**VENDIM**

**Nr. 33 Datë 26.03.2012**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LIÇENSIMIT TË  
SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A NË AKTIVITETIN E  
FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “a”; 9, nenit 13 pika 1 gërma “ç” dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “f” dhe 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18, pikat 1, gërma “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.03.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALBPETROL” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

**Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “ALBPETROL” sh.a plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht. (Mungon Ekstrakti i QKR)
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht. (mungon **neni 9, pika 3, gërma “a”** (vërtetim për shlyerjen e tatimit taksave dhe detyrimeve ndaj institucioneve të sigurimeve shoqërore).
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. Ndërsa për pikën “c” të këtij neni, subjekti nuk ka dhënë asnjë informacion.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “ALBPETROL” sh.a në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.